

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga tenderët e AKSHI-t te komunikimet me SHISH-in, si u zgjerua hetimi ndaj rrjetit të Agasit
ADRESA	https://albeu.com/lajme/nga-tenderet-e-akshi-t-te-komunikimet-me-shish-in-si-u-zgjerua-hetimi-ndaj-rrjetit-te-agasit/1027862/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 21:02:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 20:59:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1fa071f04fd97b3378cb497345b3c0faf8f970d17ef67f969efae04fb9a58b1d
TEKSTI	d5ca05ee324bebd5f17c3667d0f7f7a527e4319775bd91c39770cb23db0f8787
PAMJA	9069455e30f0b9b5d6f0889b3c230eadddd38ec7c81355ef30e59273aa8f0434

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	778461bf586d8ede01db6c61c661bea6672a51e17e10411ef43c80cdc37a0ce0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/778461bf586d8ede01db6c61c661bea6672a51e17e10411ef43c80cdc37a0ce0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga tenderët e AKSHI-t te komunikimet me SHISH-in, si u zgjerua hetimi ndaj rrjetit të Agasit



Hetimi që nisi për mënyrën e dhënies së tenderëve të AKSHI-t është zgjeruar ndjeshëm. Në fokusin e tij tashmë janë kompanitë private, administrata, grupet e strukturuar kriminale, si edhe lidhjet e dyshuara të këtyre hallkave me Policinë dhe SHISH-in.

Zhvillimet e SPAK më 22 shtator 2026 e çuan çështjen në një fazë të re, pasi në të u përfshi edhe emri i ish-drejtores së SHISH-it, Vlorë Hyseni. Përfshirja e saj lidhet me komunikime të dyshuara me persona të botës së krimit dhe ka ngritur pikëpyetje të forta mbi sigurinë kombëtare.

Në qendër të dosjes janë Ergys Agasi dhe Ermal Beqiraj. Në materialet hetimore përmenden gjithashtu ish-drejtoresha e AKSHI-t, Mirlinda Karçanaj, dhe ish-zyrtari i Policisë, Erjon Ismaili.

Më 24 shtator 2026, GJKKO vendosi ndaj Vlorë Hysenit masën "arrest në shtëpi" dhe pezullimin nga detyra. Sipas SPAK-ut, ajo po hetohet për përkrahje të autorit të krimit dhe zbulim të të dhënave sekrete.

Materialet e publikuara nga mediat, që u referohen dokumenteve të SPAK-ut, e vendosin theksin te numri dhe përmbajtja e komunikimeve mes Hysenit dhe Agasit, si edhe te fakti që këto kontakte vazhduan kur Agasi ishte në kërkim. Në dhjetor 2025, SPAK caktoi masa sigurie ndaj disa personave, ndërsa Agasi dhe Beqiraj u shpallën në kërkim. Agasi u arrestua në Shqipëri më 26 gusht, kurse Beqiraj u arrestua në Francë më 28 korrik 2026.

Edhe Mirlinda Karçanaj rezulton nën hetim. Më 16 dhjetor 2025, ndaj ish-drejtoreshës së AKSHI-t u vendos masa "arrest në shtëpi", e cila pas disa javësh u zëvendësua me "detyrim paraqitje".

Si pjesë e dosjes "AKSHI", prokurorët Altin Dumani dhe Bledar Maksuti urdhëruan edhe ekzekutimin e dy masave të tjera të sigurisë: arrestimin e Fatjon Kalluçit, shef sektori në Policinë Shkencore, dhe të Embro Sulejmanit, punonjës në shoqërinë "Agroturizëm Kodra e Kuajve" në Durrës.

Kalluci akuzohet për zbulim të akteve ose të të dhënave sekrete. ndërsa Suleimani për përkrahje të autorit të

të fundit /



Facebook rrezikon gjobë deri në 10.5 miliardë dollarë pas...



Prokuroria Speciale akuzon gjashtë persona për mashttrim dhe kri...



Ngërçi politik i kushton Kosovës mbi 40 milionë euro fonde të BE-së



Belgjika fiton 2-0 ndaj Italisë



Masakra e Mejës: Gjykata lejon gjykimin në mungesë të 53 të...



Konjufca: Marrëdhëniet rajonale duhet të ndërtohen mbi barazi...



Policia e Kosovës dhe FBI-ja zgjerojnë partneritetin për...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

krimit.

Një kthesë e rëndësishme në hetim ishte përfshirja e historisë së biznesmenit Gerond Meçe.

Më 12 gusht 2025, Meçe u largua nga banesa e tij në Tiranë. Sipas dëshmisë që ka dhënë në SPAK dhe që përmendet në dosjen hetimore, pranë tij ndaloj një automjet "Land Rover Defender" me fenelina policie. Persona të veshur me elementë të ngjashëm me uniformat e Policisë dhe BKH-së iu paraqitën si punonjës të drejtësisë dhe i kërkuan të hipte në makinë.

"Jemi SPAK-u, duhet të vish me ne, hyr në makinë", i tha njëri prej tyre, sipas dëshmisë së Meçes.

Pas disa minutash, biznesmeni kuptoi se nuk ndodhej përballë një arrestimi zyrtar. Atij iu vendos një kapuç në kokë dhe automjeti u drejtua për nga Kërraba e më pas Elbasani.

Në zonën e Gracenit, rrëmbyesit i kërkuan kodin e telefonit dhe i treguan dokumente që, sipas tij, e lidhnin pengmarrjen me aktivitetin e kompanisë së vet në tenderët e AKSHI-t. Bëhej fjalë për procedura për të cilat shoqëria kishte paraqitur ankime në Komisionin e Prokurimit Publik.

Kërkesa që iu bë ishte të hiqte dorë nga ankimimet dhe të mos merrte më pjesë në garë. Meçe ka deklaruar se e kuptoi se ishte rrëmbyer edhe sepse personat që ishin prezantuar si punonjës të BKH-së nuk dinin t'i vendosnin prangat.

Pasi pranoi të tërhiqej nga ankimimet, ai u la i lirë në një zonë rurale të qarkut të Elbasanit. Pas gjashtë orësh pengmarrje, e zbritën pranë rrethrotullimit që të nxjerr në autostradën Tiranë-Elbasan, në afërsi të Bradasheshit. Njëri prej tyre e kërcënoi me fjalët: "Nuk dua probleme nga ty, nuk dua denoncime nga ty, në të kundërt do të vrasim ty, grua, motër, nënë. Se baba ti nuk ke".

Sipas dyshimit të SPAK-ut, rrëmbimi ishte pjesë e një mekanizmi që synonte largimin e një rivali nga procedurat e prokurimit. Në këtë linjë janë përmendur Ergys Agasi dhe Ermal Beqiraj, ndërsa hetuesit po përpiqen të përcaktojnë edhe rolin e personave të tjerë.

"Në momentin që ankimimet e shtetasit Gerond Meçe, në cilësinë e ortakut të shoqërisë 'Advanced Business Solutions-ABS', krijuan një mekanizëm bllokues për përfundimin e procedurave të prokurimit pranë AKSHI-t, ai u mor peng forcërisht, duke e detyruar të heqë dorë nga të gjitha procedurat e ankimuarat", thuhet në dosjen e SPAK-ut.

Prokuroria vlerëson se tërheqja e Meçes nga ankimimet në KPP do t'u krijonte lehtësi të mëdha Agasit dhe Beqirajt për vijimin e aktivitetit kriminal në prokurimet publike. Sipas SPAK-ut, në disa raste ky aktivitet ishte penguar nga ankesat e shoqërisë "Advanced Business Solutions-ABS".

Analiza e pamjeve filmike dhe e bisedave të transkriptuara ka krijuar, sipas prokurorëve, dyshimin për një skemë të paracaktimit të procedurave, krijimit të avantazheve dhe përfitimit të paligjshëm. Në disa komunikime përmenden shprehje si "projekti bën 2 milionë, ne do ta bëjmë 4" dhe "Nuk futet as në eksperiencë", të cilat, sipas SPAK-ut, lidhen me caktimin e kriterëve të tenderëve dhe vlerave të kontratave që do të publikoheshin.

Emri i Erjon Ismailit shfaqet në linjën që prek Policinë. Meçe ka deklaruar se, para pengmarrjes, zv/drejtori i Policisë së Tiranës, Erjon Ismaili, i pezulluar nga detyra, e kishte paralajmëruar të qëndronte larg tenderëve të AKSHI-t. Kjo dëshmi është përdorur për të hetuar lidhjet e tij me grupin e dyshuar. Në dhjetor 2025 u raportua se ndaj Ismailit ishte vendosur pezullim nga detyra.

Sipas akuzave, çështja nuk lidhej vetëm me kompanitë që garonin për kontratat publike, por përfshinte një trekëndësh mes biznesit, administratës dhe Policisë. Në faqen 31 të materialit të SPAK-ut përmendet një bisedë mes Ergys Agasit dhe Ermal Beqirajt për dy tenderë në procedurë, ku del edhe kompania "ABS" e Gerond Meçes. Nga komunikimi rezulton shqetësimi i personave nën hetim për praninë e kësaj kompanie në garë.

Një kapitull tjetër i dosjes lidhet me komunikimet e Agasit me drejtuesen e SHISH-it, Vlora Hyseni. Materialet e sekuestruara gjatë hetimit, veçanërisht pas zbërthimit të telefonit të Agasit, i cili u arrestua në Durrës, kanë nxjerrë qindra telefonata, mesazhe dhe videocall-e mes tyre gjatë kohës që ai ishte në kërkim.

Disa prej kontakteve datojnë nga fundi i qershorit deri në ditët para arrestimit të Agasit më 26 gusht 2026. Në komunikime shfaqen edhe thirrje personale si "zemër" dhe "shpirt". Në raste të tjera, Hyseni i ka përcjellë Agasit të dhëna për takime dhe lëvizje të saj zyrtare.

Në një mesazh të bërë publik, Hyseni i shkruan se duhet të takohet me "KM"-në. Në një tjetër ajo përmend një takim me drejtuesin e Policisë së Shtetit dhe shpresën se ky i fundit kishte marrë porosi nga kryeministri. Këto kontakte janë përfshirë në linjën e re të hetimit.

Kështu, dosja e AKSHI-t dhe ajo që lidhet me Hyseni-Agasin paraqiten si dy kapituj që ndërthuren. Njëra pjesë lidhet me dyshimet për manipulim të konkurrencës në tenderët publikë dhe me pengmarrjen e një biznesmeni për të detyruar të tërhiqte ankimimet. Pjesa tjetër lidhet me një person në kërkim që vazhdonte të komunikonte me drejtuesen e SHISH-it dhe, sipas materialeve të publikuara, merrte prej saj informacion mbi veprimtarinë zyrtare.

Në këtë rrjet përmenden Ermal Beqiraj, Mirinda Karçanaj dhe Erjon Ismaili, ndërsa Ergys Agasi paraqitet si pika që lidh disa prej episodeve. Beqiraj shfaqet si një prej emrave kryesorë të biznesit në skemën e hetuar; Karçanaj si hallka institucionale në AKSHI; Ismaili në linjën që prek Policinë; ndërsa Meçe si biznesmeni që, sipas dosjes, u vu nën presion për t'u larguar nga gara dhe për të hequr ankimimet. Vlora Hyseni është bërë pjesë e hetimit për shkak të komunikimeve me Agasin dhe dyshimeve që lidhen me informacionin e klasifikuar.

SPAK-u, në përshkrimin e skemës së dyshuar të korrupsionit dhe pastrimit të parave në tenderët e AKSHI-t, përmend Agasin, Karçanajn, Beqirajn dhe një rrjet kompanish të lidhura me ta. Sipas dosjes, mekanizmi dyshohet se mbështetej të tenderë të paracaktuar, fatura fiktive dhe kalimi i fondeve publike te shoqëri të

kontrolluara nga personat nën hetim.

Në bazë të hetimit dhe vendimit të GJKKO-së për sekuestrimin, gjatë viteve 2023-2025 Agasi dyshohet se ka përfituar mbi 9 milionë euro në formë ryshfeti për ndikimin e tij në paracaktimin e tenderëve të AKSHI-t.

Prokurorët dyshojnë se Ergys Agasi, Ermal Beqiraj dhe persona të tjerë ende të pafunditifikuar kanë kryer veprat penale "Heqja e paligjshme e lirisë" dhe "Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës", në kuadër të një formacioni të posaçëm, "Grup i strukturuar kriminal", si dhe vepra penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal.

Për Mirlinda Karçanajn, SPAK-u përmend dyshimet për "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike", të kryer në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, si edhe për "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Dokumentet hetimore tregojnë se në këtë histori është përmendur edhe ish-ministri Damian Gjiknuri. Në komunikimet e 06.03.2019 me ish-deputetin Alqi Blako, Ergys Agasi flet për një "situatë" ku Gjiknuri dyshohet se kishte krijuar "pengesa" për realizimin e përfitimeve të paligjshme të grupit.

SPAK-u ka identifikuar si Elgerti Bixha personin e referuar në biseda me emrin "Labi". Sipas dosjes, Agasi synonte ta emëronte Bixhën administrator të një shoqërie private që kishte fituar një koncesion me ministrinë e drejtuar në atë kohë nga Gjiknuri.

Hetimi thekson se Gjiknuri shihej si pengesë për këto përfitime dhe se në komunikime diskutohej për mënyra të tjera presioni me qëllim eliminimin e saj. Në një mesazh të datës 06.03.2019, ora 21:54:43, Agasi shkruan: "Do ja *i rob, do fusim çunat pastaj".

Sipas SPAK-ut, kjo shprehje interpretohet si referencë ndaj përdorimit të lidhjeve me persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore për të ushtruar trysni dhe për të hequr pengesat ndaj interesave të grupit.

Dosja e lidh këtë episod me pengmarrjen e Gerond Meçes dhe thotë se i njëjti "modus operandi" ishte përdorur më herët edhe ndaj ish-ministrit Gjiknuri, përmes ankesave të shumta në KPP, me synim bllokimin e procedurave të prokurimit pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

SPAK-u vlerëson se krijimi i qëllimshëm i pengesave administrative, presioni dhe përdorimi i rrjeteve informale përbëjnë një skemë të qëndrueshme kriminale, të ndërtuar mbi të njëjtën mënyrë veprimi.

Shtuar më 25.09.2026 22:59

Tags: [-Politikë](#), [ergys agasi](#), [kryesore](#), [Lajmet e fundit](#), [Shqipëria](#), [Të Gjitha](#)



Fjalimi në OKB, Rama nuk përmend Kosovën dhe UÇK-në



Enio Jaço ngre alarmin për zhvillimet në vend: Balluku nën akuza, Vlora Hyseni ...



Rama në OKB: Shqipëria e ka përjetuar të ardhmen që bota ende po e diskuton



"Edi Rama dhe mazhoranca janë turpi i Shqipërisë", Salianji:...



PD propozon ndarjen e re territoriale: 100 bashki dhe 12 qarqe



Maran para sfidës në Ligën e Kombeve: Qëllimi ynë është të bëjmë ndeshjen...



Plagosja te "Zogu i Zi", policia zbardh ngjarjen



Plagoset një person te "Zogu i Zi" në Tiranë, i lënduari dërgohet me...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.